

KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË 2024



042 220 499



kontabiliteti@kkk.gov.al



www.kkk.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Adresa: Rr "Reshit Çollaku"/ Pranë ILDKP, Tiranë

Tel: 042 220 466 / 499 Site: www.kkk.gov.al E_mail: kontabiliteti@kkk.gov.al

RAPORTI
i
VEPRIMTARISË

Viti 2024

Mars 2025

P Ë R M B A J T J A

1. Hyrje
2. Aktivitetet kryesore të vitit 2024
3. Informacion mbi përditësimet e SKK-ve dhe përkthimet e SNRF-ve
 - *Standardet Kombëtare të Kontabilitetit*
 - *Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*
4. Gjetje nga monitorimi i pasqyrave financiare
5. Plani i punës për vitin 2025
6. Çështje të tjera për rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të punës së KKK-së

Shtojcë A - Realizimi i treguesve të buxhetit 2024

Shtojcë B - Buxheti i planifikuar për vitin 2025

Shtojcë C – Pasqyrat financiare 2024

1. Hyrje

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, organizëm profesional, publik dhe i pavarur, ka si mision përmirësimin e vazhdueshëm të raportimit financiar të njësive ekonomike fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Ky mision, i zërthyer në objektiva të qarta, strategji të përshtatshme dhe plane pune të koordinuara, garanton transparencën dhe saktësinë e raportimeve financiare si kusht i panegociueshëm i cilësisë së vendimeve ekonomike të operatorëve të tregut.

Tre produktet kryesore që realizon KKK-ja, në kuadër të detyrave të ngarkuara nga ligji i kontabilitetit, janë:

- hartimi dhe përmirësimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit;
- përkthimi, pa ndryshime nga teksti origjinal dhe në kohë reale, i SNRF-ve;
- monitorimi i zbatueshmërisë së standardeve të raportimit financiar

Gjithashtu, si një organizëm rregullator në fushën e raportimit financiar, KKK përpunon sistemin dhe metodat kontabël. Në rast se është një nevojë e përdoruesve apo hartuesve të raporteve financiare, KKK formulon edhe udhëzimet përkatëse kontabël. KKK me ligj ka detyrimin të kontribuojë me mendime dhe sygjerime në hartimin apo ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, me propozime konkrete për kurrikulat universitare që mbulojnë fushën e kontabilitetit si dhe të publikojë materiale informuese dhe udhëzuese në zbatim të standardeve të raportimit financiar.

Gjatë vitit 2024 përfundoi rishikimi i Udhëzuesve në zbatim të SKK-ve të rishikuara, me datë efektive 01 janar 2025.

Paralelisht me mirëmbajtjen e SKK-ve dhe Udhëzuesve të tyre për zbatim është realizuar me shumë përpikmëri dhe përkthimi i SNRF-ve dhe publikimi mbi baza vjetore i variantit të konsoliduar të SNRF-ve në gjuhën shqipe. Njësitë ekonomike të cilat kanë detyrimin të hartojnë pasqyra financiare sipas SNRF-ve kanë mundësinë (*minimalisht 1 vit para datës së zbatimit të detyrueshëm të tyre*), t'i gjejnë ato të publikuara në gjuhën shqipe në faqen zyrtare të KKK-së.

Në kuadër të procesit të integritit, KKK-ja ka kontribuar me përgatitjen e materialeve të kërkuara nga Shërbimet e Komisionit European në lidhje me çështjet e raportimit financiar, si një çështje e rëndësishme e progres raportit për Shqipërinë.

Statusi, detyrat dhe organizimi

1.1 Statusi

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit financohet nga buxheti i shtetit. KKK ka të drejtë të përdorë edhe të ardhurat që realizon nga punët që kryen. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Pjesë të këtij raporti ku trajtohen me hollësi edhe problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda po këtij afati.

1.2 Detyrat

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

- a) të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- b) të përpunojë një sistem kontabël, ku, përveç standardeve kombëtare të kontabilitetit, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- c) të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- ç) të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;
- d) të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;
- dh) të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin;
- e) të publikojë në faqen zyrtare të institucionit Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të detyrueshme për zbatim. Gjithashtu, ka të

drejtën të publikojë edhe materiale të tjera, jo të detyrueshme për zbatim, me karakter dhe qëllim informues, në funksion të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare;

ë) të botojë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standarde;

f) të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;

g) të organizojë tryeza të rrumbullakëta, seminare, konferenca dhe të tjera të ngjashme me to, me qëllim rritjen e transparencës përmes përfshirjes së palëve të interesit në procesin e përmirësimit të raportimit financiar, informimin e palëve të interesit për zhvillimet në këtë fushë, si dhe nxitjen e zbatimit korrekt të SKK-ve/SNRF-ve nga njësitë ekonomike.

1.3 Përbërja dhe organizimi

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve:

a) një anëtar propozohet nga organizata profesionale e auditimit ligjor;

b) një anëtar propozohet nga shoqatat profesionale të kontabilitetit;

c) një anëtar propozohet nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave;

ç) tre anëtarë propozohen nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave;

d) një anëtar propozohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit mandatohen me urdhër të ministrit përgjegjës për financat dhe kanë mandat 4-vjeçar. Ata mund të rimandatohen vetëm një herë me miratimin e ministrit përgjegjës për financat.

Përbërja aktuale e Këshillit është:

Ilir Binaj – Kryetar

Dritan Fino – Nënkyetar

Mirjeta Emini – Anëtare

Aurela Velo – Anëtare

Aida Bediava – Anëtare

Fatmir Bërdica – Anëtar

Fatian Devija - Anëtar

2. Aktivitetet kryesore në vitin 2024

Në zbatim të Ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 24 “Statusi dhe detyrat” dhe VKM nr. 505, datë 17.7.2019 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, neni 2 “Objektivat, përgjegjësitë dhe detyrat e KKK-së”, gjatë vitit 2024, Këshilli:

1. Është fokusuar në përmirësimin e Udhëzuesve në zbatim të SKK-ve të përmirësuara (datë efektive 1 janar 2025). Udhëzuesit kryesisht janë plotësuar me shembuj të rinj për paragrafët e ndryshuar por në disa raste janë rishikuar edhe shembuj ekzistues për të përmirësuar kuptueshmërinë e tyre. Udhëzuesit e rishikuar kanë ndjekur qasjen dhe metodologjinë e trajtimit të shembujve sipas modelit të udhëzuesit të SNRF për NjVM (2015) pasi edhe SKK-të me datë efektive 2025 janë tërësisht në përputhje me kërkesat e këtij standardi ndërkombëtar raportimi.
2. Ka përgatitur tabelën e përputhshmërisë të legjisacionit shqiptar për raportimin financiar (ligji i kontabilitetit dhe SKK-të) me legjislacionin europian të raportimit (Direktiva 34¹ të BE, të amenduar me Direktivën 2014/95/EU, Direktivën 2014/102/EU, Direktivën (EU) 2021/2101, Direktivën (EU) 2022/2464, Direktivën (EU) 2023/2864, Direktivën (EU) 2023/2775 dhe Direktivën (EU) 2024/1306. Qëllimi i përgatitjes së tabelës së përputhshmërisë është evidentimi i ndryshimeve mes dy seteve të raportimit për të mbështetur më pas procesin e transpozimit të plotë të legjislacionit europian në atë vendas. Në këtë tabelë përputhshmërie fokus do të jetë rishikimi i ligjit të kontabilitetit për të përfshirë çështjet e raportimit të qëndrueshëm. Me këtë synim, Këshilli po mbështetet gjithashtu edhe nga Banka Botërore me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë (*përgatitur nga EFRAG, adoptuar në EU*) të përkthyer në gjuhën shqipe.
3. Ka bashkëpunuar me konsulentin e projektit SQARP (financuar me fonde të Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO), administruar nga Banka Botërore) për të realizuar produktet e parashikuara në termat e referencës me objektiv forcimin e kapaciteteve të KKK-së

¹ Directive 2013/34/EU of the European Parliament and of the Council of 26 June 2013 on the annual financial statements, consolidated financial statements and related reports of certain types of undertakings, amending Directive 2006/43/EC of the European Parliament and of the Council and repealing Council Directives 78/660/EEC and 83/349/EEC Text with EEA relevance

për monitorimin e pasqyrave financiare dhe përmirësimin e cilësisë së metodologjisë së kërkimit. Këshilli tashmë disponon metodologjinë e kërkimit të kampionit përfaqësues të njërive ekonomike që do të monitorohen si dhe metodologjinë e rishikimit të pasqyrave financiare me qëllim evidentimin e cilësisë së zbatimit të SKK-ve dhe SNRF-ve. Këto dy instrumenta i mundësojnë KKK-së në vijim të zbatojë me cilësi detyrën e ngarkuar në ligjin 25/2018 “për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 24, pika (f).

4. Ka përgatitur periodikisht raportime për Ministrinë e Financave në kuadër të përgatitjes së dokumenteve të mëposhtme:

- Progres-Raportit, përsa i përket Kap.6 - Accounting & Auditing;
- Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024–2026 dhe finalizimin e PKIE 2025;
- Paketës së Raportit Kombëtar të Veprimtarisë GNPIE & Vlerësimit të Indeksit të Kapaciteteve të Integritimit Evropian;
- Planit Menaxherial të Integritimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative për vitin 2025, (PSIE 2025);

5. Ka kontribuar në përgatitjen e dokumentit “Report on assessment and monitoring the performance of State-Owned Enterprises (SOEs) and their financial reporting”. Bashkëpunimi u kërkua nga konsulenti i përzgjedhur për përgatitjen e këtij raporti pasi vlerësoi se eksperiencia e KKK-së, akumuluar në vite, lidhur me monitorimin e pasqyrave financiare të njërive ekonomike në sektorin privat dhe njohja e thelluar e parimeve të raportimit financiar do të ishte një mbështetje shumë e mirë për përgatitjen e raportit të përmendur më sipër.

6. Në përputhje me ligjin e kontabilitetit, neni 27(1) dhe 27(2) ka përgatitur dhe publikuar në faqen e internetit Raportin e veprimtarisë për vitin 2023. Raporti, pjesa ku trajtohen me hollësi problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i është dërguar për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të pikës 1, të këtij neni.

7. Ka marrë pjesë aktive në të gjitha tavolinat e punës të organizuar me objekt Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS) dhe është përfshirë me stafin e vet në trajnimet me bazë të gjerë që ka zhvilluar Ministria e Financave për përgatitjen e stafeve të kontabilitetit të Institucioneve publike në Tiranë dhe në rrethe.

3. Informacion mbi SKK-të dhe SNRF-të

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (datë efektive janar 2025)

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të cilat u rishikuan gjatë periudhës 2022 – 2023, u shpallën për zbatim nga Ministri përgjegjës për financat me Urdhër nr 16, datë 09.02.2024 “Për shpalljen e SKK-ve të përditësuara në vitin 2023” (datë efektive 1 janar 2025). Gjatë vitit 2024 standardet janë formatuar dhe përgatitur për publikim në format hard copy dhe së shpejti do të jenë në qarkullim për përdorim nga të gjithë hartuesit dhe përdoruesit e këtyre standardeve.

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNRF)

a) Përkthimi i SNRF-ve

Në vitin 2024 janë përkthyer, rishikuar dhe miratuar në KKK materialet e reja të SNRF-ve vënë në dispozicion të Këshillit nga IFRS Org sipas kontratës mes Qeverisë shqiptare përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Londër.

Titulli	Data Efektive	Urdhri i Ministrit të MFE-së
Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare <i>SNRF 18</i>	Më 1 janar 2027	
Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese <i>SNRF 19</i>	Më 1 janar 2027	
Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare <i>Ndryshime në SNRF9, SNRF 7, SNRF 19</i>	Më 1 janar 2026	
PËRMIRËSIME VJETORE TË STANDARDEVE TË KONTABILITETIT SNRF—VËLLIMI 11 <i>Ndryshime në SNRF1, SNRF7, SNRF 9, SNRF 10, SNK 7</i>	Më 1 janar 2026	

Materialet më sipër, janë dërguar për shpallje pranë ministrit përgjegjës për financat në mars 2025 dhe Urdhri për shpalljen e tyre do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të KKK menjëherë sapo të publikohet në Fletoren Zyrtare.

b) Përgatitja e variantit të konsoliduar të SNRF-ve

Në datë 03 prill 2024, BSNK në përputhje me termat e kontratës, dërgoi materialin *Red Book 2024*. Përgatitja e variantit të konsoliduar 2024 të SNRF-ve në gjuhën shqipe, u bë përmes programit TRADOS nga Inspektori për SNRF-të.

Si procedurë, në variantin e konsoliduar të vitit 2024 përfshihen SNRF-të e publikuara nga BSNK deri në dhjetor të vitit 2023. Varianti i konsoliduar 2024 përfundoi brenda muajit korrik 2024 dhe u dërgua për aprovim në BSNK. Konfirmimi erdhi me email nga përfaqësuesja e BSNK brenda muajit gusht 2024. Varianti i konsoliduar 2024 është publikuar në faqen e internetit të KKK-së (<https://kkk.gov.al/standardet-nderkombetare-te-kontabilitetit-dhe-raportimit-financiar>)

4. Gjetje nga monitorimi i pasqyrave financiare

Në zbatim të kërkesës së ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 27, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet të raportojë në lidhje me problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të pasqyrave financiare. Për përzgjedhjen e rastësishme të kampionit që monitorohet stafi logohet në portalin e QKB-së dhe shkarkon pasqyrat financiare dhe raportet e tjera të publikuara nga subjekti. Kjo është baza shkresore mbi të cilën stafi punon për të monitoruar pasqyrat dhe evidentuar rastet kur ka problematika të zbatimit të standardeve apo respektimit të kërkesave ligjore lidhur me raportimin financiar.

Sipas ligjit për kontabilitetin, të gjitha njësitë ekonomike e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin financiar mbi bazën e parimeve dhe metodave që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në varësi të kriterëve që përmbushin për periudhën/at raportuese.

Gjatë vitit 2024 janë monitoruar pasqyrat financiare të viteve 2022&2023. Në 6-mujorin e parë të vitit 2024 është mbledhur evidencë për pasqyrat e vitit 2022 dhe në 6 mujorin e dytë është mbledhur evidencë për pasqyrat e vitit 2023. Për vitin 2024 janë shkarkuar nga portali i QKB-së pasqyrat dhe raportet e tjera për **447 (katërqindedyzeteshatë)** njësi ekonomike.

Totali i njësive Ekonomike të monitorimuara	447
Njësi ekonomike /plotësojnë kriterin Auditim	110
Njësi ekonomike /nuk plotësojnë kriterin Auditim	210
Njësi ekonomike/ nuk kanë publikuar dokumentacion	17
Njësi ekonomike/ në likuidim/ ç'rregjistruar /përmbarim /sekuestro	110

Nga monitorimi rezulton që nga totali i njësive ekonomike rreth **4%** nuk kanë depozituar pasqyrat financiare vjetore raportuese në QKB, mbajtja e të cilave sipas ligjit është e detyrueshme.

A. Njësitë ekonomike që nuk plotësojnë kriterin e auditimit të pasqyrave

Grupi i njësive ekonomike që nuk plotësojnë kriterin e auditimit ndahet si më poshtë vijon:

Njësi ekonomike e vogël	82
Mikronjësi	59
Person Fizik	69
TOTALI	210

❖ Njësitë e vogla

Rezulton se 82 (tetëdhjetëedy) njësi ekonomike të vogla, kanë hartuar pasqyra financiare për vitin 2022 dhe 2023 sipas SKK-ve. Por cilësia e zbatimit të kërkesave të standardeve paraqitet:

- **25 (njëzetepesë)** njësi ekonomike kanë dhënë shpjegime të plota për pasqyrat financiare;
- **32 (tridhjetedy)** njësi ekonomike kanë publikuar shënime shjeguese jo të plota për pasqyrat financiare;
- **25 (njëzetepesë)** ose **12%** njësi ekonomike nuk kanë publikuar shënime shjeguese.

Në grupin prej 57 (pesëdhjeteshtatë) njësi ekonomike të vogla që kanë publikuar shënime shpjeguese në QKB, në 36 (tridhjetëegjashtë) raste ose në **68 %** të tyre pasqyrat financiare janë nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare. Në rastet e tjera pasqyrat janë firmosur vetëm nga administratori.

❖ Mikronjësitë

Nga **59 (pesëdhjetëenëntë)** mikronjësi që kanë publikuar pasqyrat financiare për vitin 2022&2023, rezulton se **56 (pesëdhjetëegjashtë)** njësi kanë përdorur SKK-të dhe vetëm **3 (tre)** njësi kanë përdorur SKK15. Ky është një tregues që do të vlerësohet në vijim nga KKK për të kuptuar nëse mos zbatimi i SKK 15 vjen nga ndonjë paqartësi brenda standardit 15 apo është çështje rutinë që subjektet ekonomike janë mësuar me formatet e pasqyrave sipas SKK 2 “Paraqitja e pasqyrave financiare”. Në secilin rast përpara KKK-së shtrohet detyra për normalizimin e kësaj situatë.

Edhe për mikronjësitë mbetet shqetësues fakti që nuk publikojnë shënime financiare të plota, sipas kërkesave shumë të thjeshtuara të SKK 15 “Për raportimin financiar të mikronjësive”. Rezulton se vetëm **29 (njëzetënëntë)** mikronjësi kanë publikuar shënime shpjeguese të plota për pasqyrat financiare të përgatitura sipas standardeve, **16 (gjashtëmbëdhjetë)** nuk kanë dhënë shpjegime të nevojshme për pasqyrat financiare, por kanë publikuar vetëm pasqyrat financiare ndërsa **14 (katërmëdhjetë)** nuk kanë publikuar shënime shpjeguese në QKB.

Në totalin e mikronjësive të monitoruara rezulton se **24 (njëzetekatër)** ose në **53 %** të tyre pasqyrat financiare janë nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare.

❖ Person fizik

Në grupin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike me status Person fizik rezulton se vetëm **4 (katër)** prej tyre nuk kanë paraqitur pasqyrat financiare në QKB. Në 72% të rasteve, subjektet që kanë publikuar pasqyra nuk e tejkalojnë shifrën e afarizmit prej 5 milion lekë. Ky tregues do të vlerësohet nga KKK pasi flet për një shkallë njohje të ulët të bazës ligjore në fuqi. Sipas Urdhrit të Ministrit përgjegjës për financat nr 291, datë 30.12.2022, afati për publikimin e pasqyrave financiare nga të gjitha njësitë ekonomike pavarësisht xhiros së tyre shtyhet deri më datë 1 janar 2028.

B. Njësitë ekonomike që e plotësojnë kriterin për auditimin e pasqyrave financiare

Për monitorimin e mëtejshëm të zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe të raportimit financiar për vitet 2022&2023 janë marrë në monitorim 110 njësi ekonomike që e plotësojnë kriterin për auditim të pasqyrave financiare. Ky grup përbëhet nga kategoritë e njësive ekonomike të listuara si më poshtë:

Njësi ekonomike të vogla	63
Njësi ekonomike të mesme	35
Njësi ekonomike të mëdha	13
Totali	110

Struktura juridike e **110 (njëqinddhjetë)** njësive ekonomike të monitoruara paraqitet si më poshtë:

- **89 (tetëdhjetë)** njësi ekonomike (organizimi Shpk)
- **18 (tetëmbëdhjetë)** njësi ekonomike (organizimi Sha)
- **3 (tre)** njësi ekonomike (organizimi Degë e shoqërisë së huaj)

Ky informacion është marrë në Ekstraktin Historik të subjekteve.

Standardet e përdorura për hartimin e pasqyrave financiare për vitet 2022&2023 rezultojnë:

- **14 (katërbëdhjetë)** njësi ekonomike zbatojnë **SNRF-të**
- **96 (nëntëdhjetegjashtë)** njësi ekonomike zbatojnë **SKK (1-14)**.

Klasifikimi i tyre sipas madhësisë dhe Standardeve të përdorura paraqitet si më poshtë:

<i>Standardet</i>	<i>SKK</i>	<i>SNRF</i>	<i>Total</i>
<i>Madhësia</i>			
Njësi ekonomike e Madhe	4	9	13
Njësi ekonomike e Mesme	32	3	35
Njësi ekonomike e vogël	60	2	62
Totali	96	14	110

Konstatohet se ka problematikë në setin e standardeve të zbatuar në **4(katër)** prej njësive ekonomike të klasifikuara të mëdha. Ato nuk kanë respektuar zbatimin e nenit 5 të ligjit për kontabilitetin i cili i ngarkon me detyrimin për zbatimin e SNRF-ve në pasqyrat e tyre financiare. Stafi i KKK-së do të vendosë komunikim me këto subjekte për të thelluar informacion e mbledhur dhe sqaruar pozicionin e tyre në raport me kërkesat ligjore. Nga ana tjetër vërehet se ka një zbatim vullnetar nga një grup i njësive ekonomike të vogla dhe të mesme për të raportuar sipas SNRF-ve. Në komunikimet e mëtejshme të stafit të KKK-së me këto subjekte do të kuptohet më mirë arsyeja nëse është zbatim vullnetar me kërkesë të ortakëve/aksionerëve të shoqërive apo janë njësi ekonomike të kontrolluara nga mëma të huaja dhe raportojnë sipas kërkesave të grupit ku janë pjesë. Një problematikë e hasur në 9 (nëntë) prej njësive ekonomike të mesme është se nuk kanë publikuar, sipas ligjit numrin e punonjësve dhe nuk është e qartë situata nëse klasifikohen në njësi ekonomike të mesme apo të mëdha pasi ka evidencë që vetëm një prej kushteve për klasifikim është plotësuar. Po kështu, në grupin e njësive të vogla **23 (njëzetetre)** prej tyre nuk kanë dhënë numrin e punonjësve në shënimet e tyre shpjeguese dhe nuk mund të kuptohet drejt nëse janë njësi të vogla apo të mesme. Mos klasifikimi i tyre bën që këto njësi të mos zbatojnë drejt detyrimin ligjor për të publikuar një set të shkurtuar pasqyrash apo pasqyrat e plota sipas nenit 13 të ligjit për kontabilitetin.

Vërehet se rastet kur nuk publikohet numri i punonjësve janë të shpeshta dhe këtu KKK do të kërkojë edhe nga Institucione të tjera të lidhur me çështjet e raportimit financiar që të forcojnë kërkesën ndaj subjekteve ekonomike për dhënien e këtij informacioni publik.

Nënshkrimi i pasqyrave financiare

Sipas ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 23, pika 3 kërkon që pasqyrat financiare të nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare. Nga monitorimi i njësive që kanë hartuar dhe publikuar pasqyra financiare konstatojmë në mënyrë të përsëritur se jo të gjitha njësitë ekonomike e kanë zbatuar këtë kërkesë të ligjit.

	Hartuesi	Administratori
Sipas kërkesës ligjore	66	66
Vetëm hartuesi i pasqyrave	1	
Vetëm Administratori	0	25
Pa firmosur	18	18

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin e njësive ekonomike sipas madhësisë së tyre, referuar kërkesës për firmosjen e pasyrave financiare:

Hartuesi	Të rregullta	Vetëm Hartuesi	Pa firmosur	Vetëm Admin.	Totali
Njësi ekonomike të mëdha	6	1	4	2	13
Njësi ekonomike të mesme	21		5	9	35
Njësi ekonomike të vogla	39		9	14	62
Totali	66	1	18	25	110

Problematika në lidhje me publikimin e Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare

Ndër **110 (njëqinddhjetë)** njësitë ekonomike që kanë hartuar dhe publikuar Pasqyrat Financiare, të përzgjedhura për monitorim dhe që plotësojnë kriterin për auditim të pasqyrave financiare, publikimi i raportit të auditimit dhe të tjera kërkesave lidhur me auditimin, është respektuar si më poshtë:

	Kriteri për Auditim	PO	JO
Raport Audituesi	110	35 / 32%	75
Opinionin e Audituesit	110	35 / 32%	75
Emri Audituesit	110	57 / 52%	53
Pagesa Audituesit	110	5 / 5%	105

Klasifikuar sipas madhësisë ky informacion paraqitet si më poshtë:

	Kriteri për Auditim	Raport Auditimi	Emri Audituesit	Pagesa Audituesit
Njësi Ekonomike Madhe	13	7	9	0
Njësi Ekonomike Mesme	35	16	26	3
Njësi Ekonomike Vogel	62	12	22	2
Totali	110	35	57	5

- **110 (njëqinddhjetë)** njësi ekonomike që plotësojnë kriterin për auditim të pasqyrave financiare vetëm **35 (tridhjetëpese)** ose **32 %** njësi ekonomike kanë deklaruar dhe publikuar në QKB raportin dhe opinionin e Audituesit. (54% janë Njësi Ekonomike Madhe, 46% Njësi Ekonomike Mesme dhe 19% Njësi Ekonomike e Vogël)

- **110 (njëqinddhjetë)** njësi ekonomike që plotësojnë kriterin për auditim të pasqyrave financiare vetëm **57 (pesëdhjetëshatatë) ose 52%** njësi ekonomike kanë deklaruar se kush do të jetë Audituesi i Pasqyrave Financiare të vitit 2022&2023, *(69% janë Njësi Ekonomike e Madhe, 74 % Njësi Ekonomike e Mesme dhe 35% Njësi Ekonomike e Vogël)*
- **110 (njëqinddhjetë)** njësi ekonomike që plotësojnë kriterin për auditim të pasqyrave financiare vetëm **5 (pesë)** njësi ekonomike kanë deklaruar pagesën e Audituesit në shënimet shpjeguese.

Problematika në lidhje me Raporte të tjera që shoqërojnë Pasqyrat Financiare

Raporti i Ecurisë së veprimtarisë

Njësitë ekonomike që e kanë detyrim ligjor këtë raport janë njësitë e Mëdha dhe të Mesme ekonomike. Raporti duhet të përmbajë treguesit kryesor të performancës financiare dhe të paraqesë një zhvillim të pritshëm të njësisë ekonomike.

Raporti jofinanciar

Kanë detyrim ligjor për këtë raport njësitë e mëdha ekonomike të cilat janë me interes publik dhe e tejkalojnë kriterin e numrit mesatar të punësuarve prej 500 vetë. Ky raport përmban një përshkrim të shkurtër të modelit të biznesit të njësisë ekonomike dhe politikave të saj, si dhe informacione në lidhje me mjedisin, çështjet sociale dhe ato të punësimit, kualifikimin e punonjësve, respektimin e të drejtave të njeriut.

Raporti i Drejtimit të Brendshëm

Kanë detyrim ligjor për këtë raport njësitë ekonomike me interes publik. *(njësitë e mëdha ekonomike, njësitë e mëdha e të mesme me numrin mesatar të të punësuarve mbi 250.)*

Ky informacion paraqitet si rubrikë më vete në raportin e ecurisë së veprimtarisë së ndërmarjes. Ky raport përmban informacione në lidhje me : kodet/rregullat e drejtimit të brendshëm, praktikat e drejtimit të brendshëm , sistemet e monitorimit të brendshëm, politika të ndryshme si janë zbatuar dhe rezultatet e tyre.

Raportimi i Pagesave për Institucionet Shtetërore

Kanë detyrim ligjor për këtë raport njësitë e mëdha ekonomike që janë aktive në industrinë nxjerrëse ose shfrytëzimin për lëndë drusore të pyjeve. Ky raport përmban informacion në lidhje me pagesat që u bëhen institucioneve shtetërore në mënyrë vjetore.

Në njësitë ekonomike të monitoruara, detyrimi për të përgatitur raportet e tjera që shoqërojnë pasqyrat financiare rezulton i përmbushur si më poshtë:

Raporte që shoqërojnë Pasqyrat Financiare	Tot Njësi ekonomike që bartin detyrim	Publikuar/PO	Publikuar/JO	Njësi ekonomike që nuk e kanë detyrim ligjor raportet
Raporti Ecurisë së Veprimtarisë	48	30	18	4
Raporti Jofinanciar	4	8	0	5
Raporti i Drejtimit të Brendshëm	13	6	7	0
Raportimi i pagesave për instituc.shtetërore	2	10	0	8

Të klasifikuara sipas madhësisë, detyrimi për publikimin e raporteve që shoqërojnë pasqyrat financiare paraqitet si më poshtë:

Madhësia	Raporti i veprimtarisë		Raporti jofinanciar		Raporti i drejtimit të brendshëm		Raportimi i pagesave për instituc	
	PO	JO	PO	JO	PO	JO	PO	JO
Njësi Ekon.Madhe	10	3	7		6	7	5	
Njësi Ekon.Mesme	16	19					5	
Njësi Ekon.Vogël	4		1					
Totali	30	22	8	0	6	7	10	0

Problematika të publikimit të shënimeve shpjeguese

Sipas ligjit Nr 25/2018 të gjitha njësitë ekonomike në shënimet shpjeguese duhet të paraqesin:

- numrin mesatar të punëmarrësve gjatë periudhës raportuese

Nga **110 (njëqinddhjetë)** njësi ekonomike që kanë publikuar Pasqyrat Financiare, vetëm **31 (tridhjetenjë)** njësi ekonomike kanë deklaruar numrin e punonjësve;

79 (shtatëdhjetenënte) njësi ekonomike nuk e kanë publikuar numrin e punonjësve, ku **12 (dymbëdhjetë)** ose 15% prej të cilave nuk kanë publikuar shënimet shpjeguese;

- shumën e pagave/shpërblimeve për periudhën raportuese të anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikqyrëse

Nga 48 (dyzetetë) njësi ekonomike që rezultojnë se e kanë këtë detyrim, vetëm 2 (dy) njësi ekonomike kanë dhënë korrekt këtë shënim shpjegues;

	PO	JO
Numri i punonjësve	31	79
Pagat sipas kategorive	2	46

Paraqitur sipas madhësisë së njësisë ekonomike, ky detyrim ligjor rezultojnë i plotësuar si më poshtë:

